



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 05.12.2019

RAPORT

PËR

**AKTIN NORMATIV “PËR DHURIMIN E APARTAMENTEVE FAMILJARËVE
TË VIKTIMAVE, SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.12.2019, mori në shqyrtim aktin normativ “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Relatore për shqyrtimin e këtij akti normativ u caktua deputetja znj. Klotilda Bushka (Ferhati).

Në mbledhjen e komisionit, për ta prezantuar dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishin të pranishëm z. Sandër Lleshaj, Ministër i Brendshëm, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia e Tiranës.

I. BAZA KUSHTETUESE

Projektakti i propozuar për miratim nga Këshilli i Ministrave, është akt normativ me fuqinë e ligjit sipas përcaktimeve të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA

Akti normativ i propozuar nga Këshilli i Ministrave ka për qëllim të minimizojë dhe lehtësojë pasojat e fatkeqësisë natyrore, duke u siguruar banesa familjarëve të viktimave, të cilët humbën jetën gjatë tërmetit të datës 26.11.2019 dhe që kanë pësuar dëmtime në banesat e tyre, duke i bërë ato të pabanueshme.

Në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, familjet e viktimave do të ndihmohen duke u dhuruar 17 apartamente në pronësi të Bashkisë Tiranë, të ndodhura në njësinë administrative nr.1, Tiranë. Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të dhurojnë në favor të tyre edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas legjislacionit për strehimin social.

Akti normativ parashikon dhënien e pëlqimit nga Këshilli Bashkiak për tjetërsimin e këtyre pasurive të paluajtshme në favor të familjarëve të viktimave, sipas parashikimeve të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Apartamentet që do të dhurohen për familjarët e viktimave, do të hiqen nga lista e pasurive të paluajtshme të bashkive përkatëse.

Bashkia Tiranë, brenda 2 (dy) ditëve pune, lëshon certifikatën e përdorimit sipas gjendjes dhe dokumentacionit ekzistues të objektit, pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

Kontrata e dhurimit do të realizohet sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe do të nënshkruhet nga kryetarët e bashkive në të cilat është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe përfaqësuesit e familjeve përfituese të përcaktuara në listën e dërguar nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile. Shpenzimet procedurale për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë paguhën nga bashkitë në të cilat është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Apartamenti i dhuruar do të regjistrohet në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve të familjes përfituese.

Akti normativ parashikon gjithashtu, se strukturat shtetërore do të vendosin në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë. Të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente do të mbulohen nga buxheti i shtetit.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij akti normativ, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, akti normativ i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, akti normativ është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETAR

KLOTILDA BUSHKA (FERHATË)

ULSI MANJA